



Datë: 15.09.2025
Numër Protokolli: 7781/2025

A.nr.1393/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1393/2025, të datës 17.07.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.U, kundër organit të punësimit: Ministrinë e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 15.09.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1393/2025, e datës 17.07.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.U.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi përfundimtar, i datës 25.06.2025, i Departamentit për Politikat e Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur më shpalljen e kandidatit fitues për procedurën e pranimit me numër të referencës RN00017453.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil A.U (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 17.07.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 26.05.2025, për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017453 për pozitën e punës Inspektor i Përgjithshëm, të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4803/2025, të datës 17.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Njoftimin e datës 26.05.2025; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.07.2025; Përgjigjen në kërkesë të dorëzuar të datës 04.08.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Konkursin me numër RN00017453 të datës 27.03.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin Ref.BBN-MM-5/495/2025, të datës 12.05.2025; Vendimin Nr.2588, të datës 06.05.2025; Kontratën e punës Nr.05/23/1975 të datës 21.01.2012; Kontratën e punës Nr.1/31/1976 të datës 21.01.2012; Akt emërimit të datës 23.09.2019; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit Nr.1944 të datës 10.06.2019; Kontratën e punës Nr.5/20/1979 të datës 21.01.2012; Vendimin për listën e aplikantëve të datës 26.05.2025; Njoftimin për test me shkrim të datës 03.06.2025; Testin me shkrim për kandidatin fitues; Formularët e vlerësimit të eses të datës 12.06.2025; Njoftimin e datës 12.06.2025; Njoftimin për kandidatët në intervistë të datës 18.06.2025; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 24.06.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 24.06.2025; Njoftimin për rezultatin përfundimtar të rezultatit të datës 25.06.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 29.03.2025 të kandidatit L.S së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 28.03.2025 të kandidatit A.U së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin me numër protokolli 5740/2025 ë Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së Ministria e Mbrojtje më datë 27.32.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017453, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën Inspektor i Përgjithshëm, Njësia e Inspektimeve, klasa profesional 1, një vend pune, me afat aplikimi nga data 28.03.2025 deri më datë 26.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa, sipas Njoftimit të datës 26.05.2025, të Departamentit të Politikave të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka plotësuar kriteret e konkursit pasi që i mungon përvoja e punës dhe trusti pensional apo e pagesave të obligimeve tatimore të punës për periudhën dy vjeçare pas diplomimit, të paraparë sipas kriterëve të konkursit.

Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes më datë 25.06.2025, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me dhjetë kandidatë fitues me më shumë se 70 pikë, ndërsa, si kandidat më më së shumti pikë është L.S me gjithsej 87 pikë.

Pas publikimit të njoftimit për kandidatin fitues si akt përfundimtar në këtë procedurë, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar refuzimin e aplikacionit, me pretendimin ankimor se njësia përgjegjëse nuk ka marrë për bazë përvojën e punës pas diplomimit, nën supozimin se posedon përvojën e kërkuar sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe ti mundësoj përfshirja në këtë procedurë.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit më nr. ref: RN00017453, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën Inspektor i Përgjithshëm, nga dhe ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Arsim i lartë i paspecifikuar., Përvoja e punës së kërkuar:* *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës. e për rrjedhojë Kolegji vlerëson se konkursi është shpallur sipas kritereve për grupin e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Rrjedhimisht, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

- **Nenit 9** paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj''*

- **Nenit 39** paragrafi 1, 7, 8, 9, 10 dhe 11, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi të krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

Po ashtu, për vendosje të drejtë dhe meritore Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren(QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht:

-Nenit 6, paragrafi 2: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

- Nenin 9: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 6/22 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.

- Nenit 10 paragrafi 2: 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.

- Nenit 11 paragrafi 2,: 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Rrjedhimisht, referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi më rastin e aplikimit (i dorëzuar nga organi i punësimit me përgjigjen në ankesë), dhe si rezultat ka vërtetuar se i njëjti posedon Diplomën me numër Nr.6290, të datës 27.05.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “*Hasan Prishtina*”, me të cilën dëshmohet se më datë 06.01.2018, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, ndërs, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit ankuesi ka bashkangjitur Certifikatën me numër protokolli 320/19, të datës 31.05.2019, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar praktikën profesionale në kohëzgjatje prej një viti dhe atë nga data 26.03.2018 deri më datën 25.03.2019, si dhe Kontratën e Punës në gjuhen angleze, të lidhur më datë 01.01.2020, më biznesin privat “Kontabiliteti” SHPK, Podujevë, si menaxher, mirëpo, kjo përvojë e punës nuk mbështet më dëshmi nga Trusti apo Administratat Tatimore. Po ashtu, ankuesi ka të bashkangjitur dëshmi lidhur më përvojë të punës në Procredit Bank, mirëpo, kjo përvojë ka të bëjë më periudhën para diplomimit. Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve, rrjedhë së ankuesi nuk ka arritur të argumentoj se posedon përvojë dy vjeçare profesionale siç kërkohej më konkurs, kështu që, mbi këto rrethana nuk kanë mbështetje pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë, Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes, më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim më dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7.1 ku përcaktohet se: *7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit..*

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e vlerësimit profesional dhe si pasojë e këtij vlerësimi nuk janë gjetur shkelje esenciale ligjore që si të tilla do ta cenonin ligjshmërinë e procedurës së kontestuar më ankesë.

Në kontest të përcaktimit si më lartë, Kolegji ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidatit fitues L.S, ku dhe ka konstatuar së i njëjti sipas Diplomës me numër Nr.3385, të datës 15.07.2014, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “*Hasan Prishtina*”, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë, duke marrë titullin Bachelor i Shkencave Politike, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit kandidati ka bashkangjitur Vendimin numër Nr.112/01-0000676/20, të datës 06.01.2020, për emërimin si Shefi i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Skenderajt; pozitë të cilin sipas referencës se lëshuar nga Kryetari i Komunës së Skenderajt e ka ushtruar nga janari 2020 deri dhjetor 2021 si dhe Vendimin me numër reference Nr.01/2024, të datës 04.04.2024, të lëshuar nga Ministria e MPJD, për emërimin si Këshilltar Politik për Media, në Kabinetin e Ministres së MPJD-së, pozitë të cilën vazhdon ta ushtroj. Kandidati fitues posedon dëshmi për përvoja të tjera të punës, mirëpo, Këshilli nuk trajtoj këto dëshmi pasi që përvoja e punës së përshkruar si më sipër përmbush kriterin e përvojës profesionale pas diplomimit dhe se e njëjta ndërlidhet më fushën e studimeve të kandidatit L.S.

Pra, kandidati i shpallur si kandidat fitues ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se i njëjti ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes e ka shpallur si kandidat fitues për procedurën me numër reference RN00017453, duke vepruar në pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Thënë si më sipër, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkeljeje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00017453, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.1393/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.U;
- Njesisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.